

## SURETU EZ ZELZELE

### KAPTINA 99

*E zbritur në Medine, pas sures En Nisaë, ajete: 8*

*Edhe pse kjo kaptinë është e shpallur në Medine, për çështjen që parashtron bën të mendohet se është e shpallur në Meke.*

*Kjo kaptinë shtron çështjen e dridhjes së fortë të tokës, hidhjen e mbrendisë së tokës jashtë, tmerrimin e njeriut nga dridhja e tillë, përgjegjen e saj se Zoti e ka urdhëruar, dëshminë e saj për veprat e punuara në sipërfaqen e saj dhe kthimin e njerëzve prej vendgjykimit në vendet e merituara.*

*Quhet: “Suretuz Zelzeleti” - kaptina e dridhjes, e tërmetit.*

---

## SURETU EL ADIJATË


### KAPTINA 100

*E zbritur në Meke, pas sures El Asr, ajete: 11*

*Kjo sure flet për rëndësinë dhe famën e kalorësve luftëtarë, kur sulmojnë, kur armiku dëgjon turfullimën e tyre, krismat e thundrave të tyre, kur gurët qesin gaca dhe kur ngrihet pluhuri.*

*Njeriut i tërhiqet vërejtja se nuk është mirënjohës ndaj të mirave që ia dha Zoti, është lakmues i tepërt e nuk mendon se do të dalë prej varrit i gjallë dhe me atë rast do t'i dalin në shesh të gjitha ato që i ka punuar, edhe nëse i ka mbajtur fshehtë, sepse Zoti i di të fshehtat.*

*Quhet: “Suretul Adijati” kaptina për kuajt e shpejtë në vërsulje, ngase që në fillim bëhet betimi në ta.*



8. Shpërblim për ta te Zotit i tyre janë: vendet në xhennete nëpër të cilët burojnë lumenj, e aty janë përgjithmonë, pakëputur. Allahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata të kënaqur prej Tij. E ky është për atë, që i ka pasur dronë Zotit të vet.\*

### SURETU EZ ZELZELE

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëbërësit!*

1. Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme,

2. Dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj (*barrën nga brenda*),

3. Dhe njeriu të thotë: “Ç’ka kjo (që bën këtë *dridhje*)?”

4. Atë ditë, ajo i rrëfen tregimet e veta,

5. Ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë.

6. Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre.

7. E kush punoi ndonjë të mirë, që peshonë sa grimca, atë do ta gjejë.

8. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.\*

### SURETU EL ADIJATË

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëbërësit!*

1. Pasha vrapuesit e shpejtë (*kuajt*) që hingëllojnë!

2. E që me thundrat e tyre nxjerrin xixëllima zjari nga gurët,

3. Dhe të cilët vërsulen heret në agim.

4. E me të (*vërsulje*) atëherë çojnë pluhur.

5. Dhe ashtu hidhen në mesin e grumbullit (*të armikut*).

6. Vërtet, njeriu është përbuzës ndaj Zotit të vet.

7. Edhe vetë është dëshmues i asaj (*përbuzjeje*).

8. Dhe ai është që shumë e do pasurinë.

9. A nuk e di ai se kur të nxirret çka është në varreza?

\* Ithtarët e librit, jehudi dhe të krishterë, si dhe idhujtarët, nuk i shmangeshin besimit të tyre të kotë, derisa u erdhi Pejgamberi Muhammed dhe ua sqaroi gabimin e tyre, i udhëzoi dhe i thirri për në rrugën e drejtë. Pastaj disa prej tyre i pranuan ato mësimë dhe gjetën të vërtetën.

Atyre Pejgamberi nuk u ligjëronte tjetër pos atë që ishte e drejtë, e vërtetë, pra rregulla e norma të vlefshme, që disa prej tyre kanë qenë të shënuara edhe në librat e mëparshëm. Ai i këshillonte pra, të jenë të sinqertë në adhurimet e tyre, çdo gjë të bëjnë vetëm për Zotin e tyre dhe të largohen prej gjërave të kota, ashtu siç ishte i larguar prej tyre babai i pejgamberëve Ibrahim. Falja e namazit, dhënia e zeqatit janë shenja të një besimi të drejtë.

Para se të dërgohej Muhammedi Pejgamber, ithtarët e librit ishin të pandarë në bindjen e =